



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.623/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani, Adnan Konushevcu dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Lipjan të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Lipjan, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.623/2021 e datës 16.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), e cila pretendon se me datën 16.10.2021 në fshatin Rufe i Ri, Komuna e Lipjanit, është vërejtur se baneri i subjektit politik LVV gjendet afër Qendrës së votimit Shkolla “ Migjeni” në kundërshtim me rregullat zgjedhore duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Kërkojnë nga PZAP që të zbatohet dispozitat përkatëse ndaj subjektit politik LVV për shkak të mos respektimit të këtyre rregullave. Si provë parashtroesit i ankesës ka bashkangjitur CD me video incizim dhe fotografi.

Në përgjigje në ankesë të datës 17.10.2021, subjekti politik LVV pretendon se posedojnë pëlqimin për vendosjen e banerit në shtëpi private dhe se sipas tyre në ankesë nuk është bashkangjitur asnjë provë e cila do të dëshmonte se baneri është në afërsi të shkollës dhe kërkojnë që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekt politik LDK, ka parashtuar ankesë subjektit politik LVV, me pretendim se me datë 16.10.2012 në fshatin Rufe i Ri, komuna e Lipjanit është vërejtur se banderi i subjektit politik LVV gjendet afër Shkollës “Migjeni” në kundërshtim me rregullat zgjedhore dhe kështu kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit LVV për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik LVV më datë 17.10.2021 ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë. Nga fotot e printuara vërehet se posteri i Lëvizjes Vetëvendosje është në mure të shtëpisë private dhe me asnjë provë nuk argumentohet pretendimi se baneri është i vendosur në afërsi të qendrës së votimit. Parashtruesi i ankesës nuk e ka materializuar me prova ankesën dhe në mungesë të provave duhet të refuzohet si i pa bazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë, si dhe përgjigjes në ankesë, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik LDK– Dega në Lipjan, ndaj subjektit politik LVV – Dega në Lipjan, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, është e pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik LDK, pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur të i mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre si provë i kanë bashkëngjitur fotografi të printuara dhe një CD incizim, por të njëjtat nuk dëshmojnë se kjo shkelje ka ndodhur në afërsi të shkollës dhe ky pretendim mbetet vetëm nivel pretendimesh dhe pa prova konkrete. Për më tepër, nga video incizimi , me shikim të thjeshtë nuk mund të shihet se baneri i LVV është në distancë prej 100m afër qendrës së votimit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.623/2021 më datën 18.10.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllgjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.623/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani, Adnan Konushevci dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Lipjan të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Lipjan, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.623/2021 e datës 16.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), e cila pretendon se me datën 16.10.2021 në fshatin Rufe i Ri, Komuna e Lipjanit, është vërejtur se baneri i subjektit politik LVV gjendet afër Qendrës së votimit Shkolla “ Migjeni” në kundërshtim me rregullat zgjedhore duke bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Kërkojnë nga PZAP që të zbatoj dispozitat përkatëse ndaj subjektit politik LVV për shkak të mos respektimit të këtyre rregullave. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur CD me video incizim dhe fotografi.

Në përgjigje në ankesë të datës 17.10.2021, subjekti politik LVV pretendon se posedojnë pëlqimin për vendosjen e banerit në shtëpi private dhe se sipas tyre në ankesë nuk është bashkangjitur asnjë provë e cila do të dëshmonte se baneri është në afërsi të shkollës dhe kërkojnë që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekt politik LDK, ka parashtruar ankesë subjektit politik LVV, me pretendim se me datë 16.10.2012 në fshatin Rufe i Ri, komuna e Lipjanit është vërejtur se banderi i subjektit politik LVV gjendet afër Shkollës “Migjeni” në kundërshtim me rregullat zgjedhore dhe kështu kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit LVV për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik LVV më datë 17.10.2021 ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë. Nga fotot e printuara vërehet se posterit i Lëvizjes Vetëvendosje është në mure të shtëpisë private dhe me asnjë provë nuk argumentohet pretendimi se baneri është i vendosur në afërsi të qendrës së votimit. Parashtruesi i ankesës nuk e ka materializuar me prova ankesën dhe në mungesë të provave duhet të refuzohet si i pa bazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë, si dhe përgjigjes në ankesë, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik LDK– Dega në Lipjan, ndaj subjektit politik LVV – Dega në Lipjan, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, është e pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik LDK, pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur të i mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre si provë i kanë bashkëngjitur fotografi të printuara dhe një CD incizim, por të njëjtat nuk dëshmojnë se kjo shkelje ka ndodhur në afërsi të shkollës dhe ky pretendim mbetet vetëm nivel pretendimesh dhe pa prova konkrete. Për më tepër, nga video incizimi, me shikim të thjeshtë nuk mund të shihet se baneri i LVV është në distancë prej 100m afër qendrës së votimit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.623/2021 më datën 18.10.2021

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllgjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.